

ELEMENTET PARAHISTORIKE NË BESIMET E ARBËRESHËVE TË ZARËS

ALEKSANDËR STIPÇEVIÇ

Rr. Marulićev trg 12

Zagreb, Croatia

E-mail: astip@net.hr

Hyrje

Besimet e arbëreshëve të Zarës janë të mbushura përplot me tregime të çuditshme fantastike e simbolike, rrënjët e të cilave duhet t'i kërkojmë, para së gjithash, në ato fshatra të Liqenit të Shkodrës, të cilat ata i lëshuan në gjysmën e parë të shekullit XVIII dhe u vendosën në afërsi të mureve të Zarës, në Dalmaci. Ata, edhe pse lanë vendbanimet, gjënë e gjallë dhe pasuritë e patundshme, në udhëtimin e largët e të panjohur morën me vete kujtimet dhe botën shpirtërore, të cilat me shekuj u ruajtën te të parët e tyre, si dhe te ata vetë. Ata, me ardhjen në Dalmaci, me xheloz, ruajtën shumë elemente tradicionale të kulturës shpirtërore, sidomos besimet, simbolet, gjuhën e tregimet e tyre, këngët dhe begati të tjera jomateriale.

Në atdheun e ri u gjetën në gërshtë midis dy popujve dhe dy kulturave të panjohura për ta. Nga njërin anë ishte elementi rural kroat, tek i cili, natyrisht flitej kroatishtja; dhe, nga ana tjetër ishte kultura urbane e qytetit të Zarës, në të cilën elementi italian ishte shumë i fuqishëm jo vetëm për administratën venedikase, e cila italishten e kishte gjuhë zyrtare.

Është me rëndësi të theksohet këtu se krahina midis Liqenit të Shkodrës, nga njëra anë dhe Detit Adriatik, nga ana tjetër ka qenë jashtëzakonisht konzervatore. Në këto hapësira me shekuj nuk ka pasur ndryshime dhe çrregullime të mëdha etnike. Nuk kishte udhëkryqje të rëndësishme, të cilat do t'i përshtateshin ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike. Ndaj edhe jeta rridhte ngadalë. Për këtë arsye, në këto hapësira, janë ruajtur elemente shumë të lashta kulturore e shoqërore, disa prej të cilëve rrënjët e tyre i arrijnë në kohëra shumë të hershme, parahistorike.

Për shkak të të gjitha këtyre rrethanave banorët e fshatrave të atjeshme, të cilët në gjysmën e dytë të shekullit XVIII u vendosën në rrethinën e Zarës, me këmbëngulje dhe gjatë kohë ruajtën identitetin e tyre. Kjo do të thotë se flisnin të folmen e tyre geqe, me xheloz ruajtën format e strukturës arkatike shoqërore

dhe familjare, por ruajtën edhe shumë tregime, këngë dhe sidomos besimet e tyre popullore e simbolet fetare sipas të cilëve, ata, gjatë kohë dalloheshin prej banorëve të Zarës dhe të fshatrave përreth.

Në këtë studim dëshirojmë ta tërheqim vëmendjen në disa prej këtyre elementeve të stërlashta të kulturës tradicionale, me të cilët mendojmë se dëshmohet jo vetëm prejardhja e tyre nga atdheu i të parëve, por edhe për rrënjët e tyre në kohëra të largëta parahistorike.

Kroni

Vendbanimi Arbanasi (arb. Arbënes) gjendet në pjesën jugore të siudhesës së Zarës. Është i njohur për ujërat nëntokësore. Kur kanë ardhur të mërguarit kanë hapur puse dhe shpejt e kanë gjetur damarin e ujit. Këto burime uji i kanë quajtur *kroni*. Këtë emërtim ia kanë dhënë edhe burimeve të shumta të ujit të gjallë në vendbanimet përreth. Këtë hidronim arbëreshët e kanë sjellë nga atdheu i të parëve, për çka flet edhe fakti se hidronimi *kron (i)* është krejtësisht i panjohur në Dalmacinë Veriore, pra në krahinën në të cilën ardhësit shqiptarë e vendosën vendbanimin e tyre të ri. Nga ana tjetër ky hidronim është shumë i shpeshtë dhe i zakonshëm në vendbanimet shqiptare, si në vetë Shqipërinë, ashtu edhe në Kosovë dhe gjetiu. (Mjafton të përmendet se në vendbanimin Galicë të Kosovës janë regjistruar dhjetëra lokalitete, më saktë burime të ujit që në emërtimin e tyre përmbajnë hidronimin ujë: Tahiri, 2006: 225 – 228). Po ashtu është i shpeshtë edhe në jug të Malit të Zi, pra, në krahinën në të cilën dikur jetonin arbëreshët e Zarës (rreth hidronimit *kron(i)* në krahinën e Malit të Zi prej nga janë shpërngulur arbëreshët e Zarës, shih: Dabaj, 2008, 27: 19). Nuk ka dyshim se hidronimi *kron(i)*, përkatësisht *krua*, *kroi* në Ballkan është shumë i vjetër (fjalët *krua*, *kroi* në shqip kanë kuptimin burim uji. Fjalor, 1981: 891). Sipas disa gjuhëtarëve është i origjinës paragreke (për etimologjinë e hidronimit, shih: Çabej, 1976: 292 – 293, zëri: *krua*, *krue*), prandaj mund të konsiderohet si

njëri prej elementëve më të vjetër gjuhësorë të ruajtur në Arbënesh. Nëse hamendjet tona janë të sakta, se ky hidronim është në ndërlidhje edhe me besimet e lashta për ujin si burim të jetës, atëherë në të kemi edhe njërin prej elementëve më të vjetër religjioz në Ballkan.

Nxiri

Prejardhjen e tij prej kohërave më të lashta parahistorike e sjell edhe një tregim, të cilin sot e tregojnë vetëm arbëreshët e moçëm. Ky është tregimi për fenomenin *nxiri*. Sipas tij ata janë sytë që e vështrojnë njeriun nga syprina e tokës dhe ashtu si ai lëviz rreth tyre, ashtu ata e përcjellin lëvizjen e tij. Vice Kotlari plak (më 2009 kishte 91 vjet) e di edhe vendin prej nga vështrojnë këta sy. Sipas tij është vendi Tokshin, në trollin e Perishinëve, në qendër të vendbanimit Arbënesh.

Arbëreshi tjetër i Zarës, Benito Nikpali, diçka më i ri në moshë, përkujton një fjalë të urtë lidhur me këtë fenomen të çuditshëm: *Njerin pe nxiri, vajzën pe nxiri* (Sheh njeriun, sheh vajzën), që do të thotë se këta sy me shikim e përcjellin gjithkënd.

Sytë që nga toka e vështrojnë njeriun çojnë në konstatimin se ata janë pjesë përbërëse e botës së gjallë dhe ky organizëm i gjallë është vetë Toka.

Dëshminë më të afërt në besimin se Toka është organizëm i gjallë e hasim në malin Luboç në afërsi të Bihaçit në Bosnë. Në majën e këtij mali gjendet një rrafshirë, e cila është e pasur me burime të ujit të gjallë. Sipas shpjegimeve të fshatarëve të atjeshëm, burimi i ujit të gjallë në atë rrafshirë është dëshmi se Toka është organizëm i gjallë. Njëri prej fshatarëve tregon se paraqitja e ujit në një majë mali të lartë mund të krahasohet me gjakun në maje (tepe) të kokës së njeriut. Pse gjaku gjendet në maje të kokës së njeriut, sepse njeriu është organizëm i gjallë dhe, sipas kësaj, edhe uji në malin e lartë Luboç është dëshmi se Toka është organizëm i gjallë (këtë tregim e ka shënuar dhe komentuar Shimiç, 1932: 90 – 91).

Mendimin për Tokën si organizëm të gjallë e hasim që në Antikë, p.sh. te Platoni dhe autorët e tjerë. Ndaj Nënës Tokë i dhanë emrin perëndesha Geja “e gjallë”. Këtë teori që e hasim edhe sot e kanë aktualizuar, që në shekullin XVIII, shkencëtarët, që dëshirojnë të sjellin teori bizare, të cilat me dëshirë i lexojnë bota joshkencore. Me këtë teori e argëton botën studiuesi anglez James Lovelock.

Tregimet që i rrëfejnë këta shkencëtarë nuk duhet këtu t’i komentojmë dhe nuk është e nevojshme më hollësisht t’i arsyetojmë. Për ne është me rëndësi të thuhet se jo vetëm tek filozofët dhe ‘natyrorët’, por edhe në besimet popullore hasim besimin për Tokën si

organizëm të gjallë. Është me rëndësi se ky besim është i pranishëm edhe tek arbëreshët e Zarës.

Është evidente se arbëreshët e Zarës, këtë tregim, nuk e kanë dëgjuar nga kroatët përreth dhe as në qytetin e Zarës, por e kanë sjellë nga atdheu i të parëve. Në dobi të kësaj flet edhe emërtimi shqip i këtij fenomeni në Arbënesh. Edhe pse duket se është ashtu, duhet prap të tërheqim vëmendjen se tregimi për *nxirin* në fshatrat prej nga ata janë shpërngulur sot është krejtësisht i panjohur (Njohësit e mirë të krahinës përreth Liqenit të Shkodrës, pra paraatdheut të arbëreshëve të Zarës, prof. Dr. Simë Dobreci dhe Ismail Doda më kanë informuar se askund nuk kanë dëgjuar për praninë e *nxir* – *it* dhe asqë ia dinjë kuptimin këtij emërtimi). Të përmendim edhe këtë se ky nuk është rasti i vetëm që arbëreshët e Zarës të kenë ruajtur disa elemente të kulturës popullore, të cilët në ndërkohë janë harruar në atdheun e të parëve të tyre. Pa marrë parasysh këtë, nuk ka kurrëfarë dyshimi se arbëreshët e Zarës, këtë tregim e kanë sjellë nga atdheu i të parëve dhe duhet të vendoset në kontekst të mitologjisë paleobalkanike, e cila nuk është e domosdoshme të jetë e prejardhjes romake ose greke, por e botës së lashtë mitologjike, rrënjët e të cilës humbasin në errësirën e parahistorisë.

Kali dhe bota e të vdekurve

Të shumta janë tregimet që flasin për lidhshmërinë e kalit me botën nëntokësore. Për të në Arbënesh rrëfehen shumë tregime. Këtu do të përmendim vetëm dy, të cilët janë interesantë për temën tonë:

(1) Sipas të parit rrëfëhet se dikur kanë jetuar një vajzë dhe një djalë, të cilët kanë qenë të dashuruar shumë dhe për çdo ditë kanë qenë bashkarisht. Një ditë trimi vdiq dhe vasha e tij e pangushëlluar për çdo ditë çonte lule në varrin e tij. Një ditë te varrezat erdhi shumë vonë, më vonë se ditëve të tjera, edhe atë, në mbrëmje kur po errej. Megjithatë, ajo kishte vendosur të verë lule në varrin e trimit. Kur arriti para portave hyrëse të varrezave, pa një kalë të bardhë. Vetëm kur iu afrua pa se ai nuk ishte kalë shtëpie, por dukej ndryshe prej atyre që, zakonisht, kullosnin barë në afërsi të varrezave. Menjëherë vërejti se atë kalë, i veshur në të bardha, e kaluronte trimi i saj i vdekur. Kur vasha iu afrua kalit, trimi ia shtriu dorën dhe i ndihmoi të hipte në kalë. Kështu bashkarisht hynë në varreza. Kur arritën te varri i trimit, përnjëherë u zhdukën trimi dhe kali, kurse ajo vetë u gjend pranë varrit.

Vasha edhe pas kësaj ngjarjeje vazhdoi të çojë lule në varrin e trimit, por kurrë më nuk e takoi as të fejuarin e saj, as kalin e bardhë.

(2) Tregimi i dytë flet për sjelljen e kalit në afërsi të varrezave. Sa herë që plaku Gjobe kalonte pranë varrezave, kuajt që e tërhiqnin karrocen, shqetësoheshin shumë kur ishin afër portave hyrëse të varrezave. Kuajt hingëllinin, kërcenin dhe nuk donin të shkojnë tutje. Atëherë Gjobe – ja zbriste nga karroca, hiqte kapelën, përkulej dhe para kuajve bënte kryq. Kjo i qetësonte kuajt dhe ata vazhdonin rrugën.

Jo vetëm këto dy tregime, por edhe shumë prej tyre që edhe sot rrëfohen në Arbënesh, dëshmojnë se kuajt, në një farë mënyre të fshehtë, kanë qenë të lidhur me varrezat, përkatësisht me botën e të vdekurve.

Është e ditur se gjithandej Europës kanë ekzistuar tregime të ndryshme për lidhshmërinë e kalit me të ndjerët të propozur në varreza dhe disa prej tregimeve të këtilla janë regjistruar që në kohën antike. Prej tyre më i njohur është ai i Lenorës, të cilën e kanë përpunuar shumë shkrimtarë dhe ka qenë motiv i shpeshtë i këngëve dhe tregimeve popullore (më gjerësisht shih: Shishman, 1899: 151 – 160). Këtu, për ne është me rëndësi të veçantë, e dhëna se ky motiv është shumë i shpeshtë në letërsinë popullore shqiptare (Banovac, 1925, 6, 3 - 4: 72 – 74; Dozon, 1879: 136 – 139; Çabej, 1934, 6; Çabej, 1975, V: 92 – 96; Trnavci, 1975), ndaj për tregimet që rrëfohen në Arbënesh nuk është e nevojshme të kërkojmë krahasime tek popujt e tjerë të Europës.

Tregimet për kalin dhe lidhshmërinë e tij me botën e të vdekurve, arbëreshët e Zarës, padyshim, i kanë sjellë nga atdheu i dikurshëm, por gjithashtu është e vërtetë se fantazia popullore i ka dhënë shumë hollësi të reja, përkatësisht ndonjë hollësi, me të cilën e ka pasuruar tregimin burimor.

Gjarpëri i vatrës

Besimi se gjarpri i shtëpisë është personifikim i shpirtit të të parëve, në siujdhesën ballkanike, si te popujt e tjerë të botës, është shumë i lashtë dhe daton nga koha antike e deri në ditët tona. Në Arbënesh edhe sot, më pleqtë, flasin se gjarpri i shtëpisë nuk guxon të vritet «përse bolla e shpiës është shpirti i të dekunavet» (sepse gjarpri i shtëpisë është shpirti i të vdekurve). Besohet se mbytja e tij i sjell fatkeqësi shtëpiakëve.

Është interesant tregimi se gjarpri i shtëpisë shëtitet rreth shtëpisë dhe kështu shënon territorin që ai ruan. Besimi në gjarpurin që ruan shtëpinë dhe njerëzit e saj, kuptohet nuk do të ishte asgjë sikur të mos ishte karakteristik për arbëreshët e Zarës. Për këtë gjarpër janë shkruar shumë tregime që në kohën antike, por ata janë edhe më të lashtë. Etnologët dhe historianët e religjionit në siujdhesën ballkanike (mjafton të përmenden: Hirtz, 1930, I: 243 – 254; Zečević, 1970, 35 – 36: 141 – 150; Đorđević, 1958, II: 120 – 133; për

kultin e gjarpurit tek shqiptarët: Poghirc, 1986, I: 178 – 180) e kanë studiuar mirë kultin e gjarpurit të shtëpisë dhe nga studimet e tyre mund të dalë konstatimi se ky kult është shumë i lashtë dhe shumë i përhapur, sa që është vështirë tregimeve të Arbëneshit t'i gjendet zënafilla. Megjithatë, duhet të tërheqim vëmendjen në paraqitjet e shumta të gjarpurit në pllakat mbivarrore, si dhe në kryqat mbivarrorë, të cilët hasen pikërisht në ato krahina të Malit të Zi dhe të Shqipërisë Veriore prej nga janë shkukur arbëreshët. Ata ruajnë varrin nga forcat e këqia, ndërkaq varri, siç është e ditur, është shtëpia në të cilën mbeturinat e të ndjerit kanë gjetur shtëpinë e vet të dytë. Këta gjarpërinj, në të vërtetë, ruajnë shtëpinë e të ndjerit, në të njëjtën mënyrë sikurse që e kanë ruajtur shtëpinë e tij derisa ishte gjallë. Është interesant se disa prej dëshmive të këtilla janë të kohës më të re (Stipčević, 1983: 625 – 629). Prandaj kultin e zgjeruar të gjarpurit të shtëpisë në Arbënesh duhet sjellë në lidhje me atë të atdheut të të parëve, si dhe me besimet e largëta të kohës parahistorike (domethënë ilire).

Bullari (kr. Sljepić = qorrësi)

Emri *bullari* shenjon sipas disave (K. Krstić) «blavor, sljepić (=qorrësi)» (Krstić, 1987: 31), sipas të tjerëve (G. Wiegand) ai është «gjarpër i madh, gjarpër» («grosse Schlage», «Drache») (Wiegand, 1911: 225). Sipas linguitit italian Carlo Tagliavini ai është «sljepić», për të cilin në Arbënesh ka dëgjuar se «rrëfëhet që bullari sheh vetëm të Premten e Madhe» (arb. *Thoet se bullari pon vet në të Prende të Madhe*) (Tagliavini, 1937: 90). Në shikim të parë kjo gjallesë vërtetë duket si gjarpër, ndaj nuk habitemi pse edhe sot arbëreshët e Zarës flasin për të si për gjarpër. Megjithatë, dihet se fjala është për bullarin, zhapinin e gjatë (rreth një metër) dhe të parrezikshëm, i cili jeton në Europën Juglindore dhe në Azi. Fshihet nëpër kaçuba dhe kur dikush kalon pranë kaçubës, ai fryhet dhe fitohet përshtypja sikur ai fryn. Për këtë arsye në Arbënesh ka mbetur fjala e urtë *Po fryn si bullari*. Bullari tanimë nuk haset nëpër vendbanimet përreth Arbëneshit (p.sh. në vendin Shkambat, ku dikur dilte), sepse urbanizimi e ka përzënë nga vendbanimi i dikurshëm. Por, edhe sot ai zhapin ka mbetur në kujtesën popullore, më së shumti sipas fjalës së urtë të përmendur. Është me rëndësi të përmendet se vetë emri i këtij zhapini etimologjikisht lidhet me emrin e gjarpurit (bolla) dhe emri *bullari* është fjalë autoktone (më gjerësisht Çabej, 1988, VIII, zëri *bollë*: 283 – 285 dhe zëri *bullar*: 366 – 367) prej të cilës në krahina të Siujdhesës Ballkanike kanë dalë variantat të shumta. Në besimet popullore të popujve ballkanikë kjo shtazë konsiderohet herë gjarpër, herë sljepić (=qorrësi), pikërisht ashtu si e perceptojnë edhe

arbëreshët e Zarës (për emërtimet e kësaj kafshe shih: Skok: 1971, II: 169 – 170).

Çufra dhe shpendi shtegtar lauresha

Veza si simbol i jetës së përtëritur te arbëreshët e Zarës është e pranishme shumë. Për këtë rast kam veçuar vetëm një që mendojmë se është më interesante për temën tonë.

Arbëreshët, me rastin e përgatitjeve për Ditën e Buzmit. Në këtë ditë shkonin në Sokin brig, i cili gjendej në afërsi të vendbanimit dhe këtu kanë shkullur bashkë me rrënjë kaçubën *çufra*. Kjo kaçubë ka dimensionet tridhjetë centimetra gjerësi dhe po kaq lartësi, kurse përbëhet nga degë të shpeshta dhe të holla, të cilat janë shumë të përshtatshme për ndezjen e zjarrit. Natën e Buzmit me këtë kaçubë kanë ndezur buzmin në vatrën e shtëpisë. Për shkak të lehtësisë së ndezjes së *çufrës* kjo kaçubë gjithmonë ka qenë e lidhur me ndezjen e zjarrit.

Sipas besimeve të moçme në Arbënes, në vendin ku rritet kjo bimë, në pranverë vinte shpendi shtegtar lauresha (në arb. *kapeluj*) dhe aty bënte çerdhen, ku bënte vezët e veta.

Pra, në këtë tregim kemi, fillimisht *çufrën* që digjet dhe pastaj, në të njëjtin vend, ku ajo rritet, shpendin lauresha, si lajmëtar i pranverës dhe i përtëritjes biologjike të natyrës, i bën vezët të cilat në të gjitha religjionet simbolizojnë rilindjen dhe jetën.

Nuk është vështirë të njihet një variant i njohur i tregimit për Feniksin e egjiptianëve të moçëm, pastaj grekëve dhe romakëve. Për këtë tregim mitologjik kemi të gjitha elementet e tregimit të arbëreshëve të Zarës për kaçubën të cilën arbëreshët e quajnë *çufra* (në kroatisht, duket se është *smilje*) dhe shpendin shtegtar lauresha, e cila në vjeshtë shkon në jug dhe kthehet në pranverë kur nis përtëritja biologjike e natyrës.

Sytë e këqinj

Arbëreshët e Zarës në të kaluarën kanë besuar bindshëm, disa besojnë edhe sot se ekzistojnë gra të këqia, të cilat me shikimin e tyre mund të shëmtojnë njerëz të tjerë, sidomos fëmijët, bile edhe kafshët. Ky besim është shumë i lashtë dhe ka qenë i shtrirë në të gjithë botën, ndaj e kanë njohur edhe ilirët në periudhën parahistorike dhe historike. Duket se ilirët kanë qenë shumë supersticiozë dhe te ata besimi në shikimin e keq ka qenë jashtëzakonisht i popullarizuar. Për këtë dëshmojnë shkrimtarët antikë romakë, të cilët veçanërisht theksojnë këtë besim popullor te ilirët, p.sh. Plini dhe Aul Gali (Stipčević, 1991³: 71).

Vetë fakti se besimi në shikim të keq ka qenë shumë i përhapur te ilirët e moçëm nuk do të thotë se arbëreshët e Zarës atë e kanë marrë prej tyre, ndaj

edhe dukuria e këtij besimi te këta nuk duhet patjetër të komentohet si mbijetojë e këtyre kohërave të lashta, por megjithatë nuk mund të kontestohet lidhshmëria e këtij besimi te arbëreshët e Zarës me besimet e lashta popullore paleoballkanike.

Në Arbënes, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, në një masë edhe më vonë, kanë ekzistuar gra, të cilat, sipas besimit të banorëve vendas kanë pasur fuqi që me shikimin e tyre t'i shëmtojnë të tjerët. Më shpesh të tilla kanë qenë gratë krejtësisht normale, të cilat publikisht nuk e kanë zbuluar këtë fuqi të tyre, megjithatë, disa sosh, njerëzit, kanë arritur t'i identifikojnë. Kështu flitet se fuqia e tyre keqbërëse është përhapur në vend dhe njerëzit kanë ndërmarrë masa që ta pengojnë ndikimin e këtyre grave në shëndetin dhe mirëqenien e individit, të cilin ato e kanë yshtur. Këto masa, përveç të tjerash, kanë përfshirë vendosjen e lëndëve të ndryshme nën pragun e derës, si p.sh. copëra thonjsh, flokë, hudhra etj., me të cilat janë përpjekur ta pengojnë hyrjen e të keqes në shtëpi.

Pasojat e shikimit të këtyre grave të këqia mund të kenë qenë të kobshme për njerëzit, sidomos për fëmijët. Vetë gratë kanë qenë të vetëdijsme për keqbërjen e fuqisë së syve të tyre, ndaj disa sosh bile ua kanë tërhequr vëmendjen fqinjëve që kanë pasur fëmijë të vegjël, që t'i çojnë diku larg prej tyre, në vende ku nuk arrinte fuqia e keqe e syve të tyre.

Këtu mjafton të përmendet se këso gra gjithmonë shumë ka pasur dhe se njerëzit janë detyruar të ndërmarrin një varg masash që mos të jenë të yshtur dhe nëse tanimë janë yshtur, janë detyruar të ndërmarrin diçka që ta heqin yshtjen dhe kështu ta shpëtojnë veten dhe familjen e vet. Përveç të tjerash, kanë varur rreth qafës amulete të ndryshme dhe kështu janë përpjekur ta neutralizojnë fuqinë e keqe që e kanë pasur këto gra.

Besimin në sytë e këqinj, përkatësisht në shikimin e keq te arbëreshët e Zarës a mund ta bijmë në lidhje me besimet parahistorike në Siujdhesën Ballkanike? Arkeologu Qiro Truhelka thekson se, besimi në sytë e këqinj, ka qenë veçanërisht i përhapur në periudhën parahistorike në Ballkan dhe se te shqiptarët është i pranishëm edhe sot (Truhelka, 1900: 7 – 8). Nga ky fakt, konstaton Truhelka, ky besim është mbijetojë e periudhës ilire, që na jep të drejtë edhe besimin në sytë e këqinj te arbëreshët e Zarës ta vendosim në kontekst të mbijetojave të besimeve të lashta paleoballkanike.

Përfundim

Rastet këtu të përmendura sigurisht nuk janë të vetmit te arbëreshët e Zarës, që mund të bihen në lidhje të

drejtpërdrejtë me rrënjët parahistorike, në pjesën më të madhe ilire. Analiza e thellë e hajmalive dhe talismanëve, respektimi i disa kafshëve, analiza e marrëdhënieve të njerëzve të gjallë me të ndjerët etj., pa dyshim, zbulon edhe shumë lëndë, e cila do ta lidhë botën shpirtërore të arbëreshëve të Zarës me kohërat e largëta, parahistorike.

Bibliografia:

BANOVAC, Stjepan (1925), »Jedan primjerak arbanaske narodne pjesme o pohoru mrtvoga brata udanoj sestri i nesto o toj vrsti pjesama«: *Vjenac*, Zagreb, 3, knj. 6, nr. 3 – 4: 72 – 74.

ÇABEJ, Eqrem (1976), *Studime gjuhësore I. A – O*. Prishtinë.

ÇABEJ, Eqrem (1988), »Studime etimologjike në fushë të shqipës«: *Studime gjuhësore VIII*, Prishtinë: Rilindja.

DABAJ, Gjokë (2008), »Toponimet e Krythës«: *Buzuku*, Tuz, nr. 27: 19.

GJORGJEVIC, Tihomir (1958), *Priroda u verovanju i predanju nasega naroda*. Knj. II. Beograd, SANU.

KRSTIC, Kruno (1987), *Rjecnik govora zadarskih Arbanasa*. Zadar: Mjesna zajednica Arbanasi.

SHIMIC, Ante (1932), »I zemlja je tijelo«: *Zbornik za narodni zivot i obicaje juznih Slavena*, Zagreb, 28, sv. 2.

STIPCEVIC, Aleksandar (1983), »Zmija kao cuvarica groba. Prilog proucavanja ilirskih ostataka u suvremenim narodnim vjerovanjima«: *Zbornik za narodni zivot i obicaje juznih Slavena*, Zagreb, 49.

STIPCEVIC, Aleksandar (1991), *Iliri*. III izdanje, Zagreb: Skolska knjiga.

TAGLIAVINI, Carlo (1937), *L'Albanese di Dalmazia*. Firenze: Leo S. Olschki: 90.

TRUHELKA, Ciro (1900), *Les rastes illyriens en Bosnie*. Paris: Impr. de la Cour d'appel.

ZECEVIC, Slobodan (1970), »Poreklo nasih verovanja o kucnoj zmiji«: *Narodno stvaralastvo – folklor*, Beograd, 9, br. 35 – 36.